

REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr 1203 prot.

Gramsh, më 18/03/2026

Njoftim për Thirrjen e Mbledhjes së Radhes të Këshillit Bashkiak


Të nderuar Këshilltarë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar neni 53 pika 3 germa a), Rregullores “Për funksionimin e Këshillit” neni 57 pika 1 germa a), njoftoj se mbledhja e radhës e muajit **MARS** do të zhvillohet ditën **PREMTE** datë **27/03/2026 ora 10:00** në sallën e mbledhjeve të Këshillit me rend dite si mëposhtë:

- 1- Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Shkurt 2026 (fondi 6%).
(Sek.Ndihmës Ekonomike)
- 2- Për miratimin e planit të punës, për parandalimin dhe masat që do të merren për mbrojtjen e fondit pyjor/kullosor publik nga zjarret.
(Dr.Zhvillimit Ekonomik dhe Shërbimit Pyjor)
- 3- Për disa ndryshime në nivelin e pagave dhe shpërblimeve, të punonjësve e personave, të emëruar ose të zgjedhur të bashkisë Gramsh, për vitin 2026 të vendimit nr. 86 datë 27.12.2024 “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelin e pagave e shpërblimeve, të punonjësve e personave , të emëruar ose të zgjedhur të bashkisë Gramsh” .
(Kryetari)
- 4- Për një ndryshim në Vendimin nr.48, datë 30.06.2023 të Këshillit Bashkiak “Për formimin e komisioneve të përhershme të këshillit të bashkisë”
(Kryetari Këshillit)
- 5- Për miratimin e tavaneve të Buxhetit Afat -Mesëm 2027-2029
(Dr.Zhvillimit Ekonomik)
- 6- Raport mbi Veprimtarinë e Këshillit Bashkiak për vitin 2025 dhe Transparencën e Vendimmarrjes dhe Buxhetit.
(Kryetari Këshillit,Dr.Zhvillimit Ekonomik)
- 7- Për një ndryshim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 36, datë 29.04.2024 “Për miratimin e një sipërfaqe truall prej 540 m²(pesëqind e dyzetë) metra katrorë, pjesë e Pasurisë 8/132, Zonë Kadastrale 1842 e cila është në pronësi të Bashkisë Gramsh, si truall për ndërtimin e objektit, që do të ndërtohet nga Enti Kombëtar I Banesave (EKB) me kosto të ulët , për qëllime strehimi.”
(Dr.Planifikimit dhe Kontrollit të territorit,Mjedisit dhe Pronës)
- 8- Kërkesa të qytetarëve ; Të tjera

Duke ju falenderuar!

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT



Enis ZANI



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH
Kryesia

Nr. 1208 prot.

Gramsh, më 18.03 /2026

VENDIM


PËR
MIRATIMIN I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 17,56, 57 dhe “Rregulloren për Organizmin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Gramsh”, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e dates 17.03.2026:

VENDOSI

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës për muajin Mars të Këshillit të Bashkisë Gramsh, e cila do të mbahet në datën 27.03.2026 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Gramsh, Deputetët e qarkut dhe personat apo/dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Xhulia GJINI



Kryetari i Këshillit Bashkiak
Enis ZANI

